



Prej vitesh, Kryqi i Kuq Shqiptar zhvillon programin e dhurimit vullnetar falas të gjakut, si alternativa më e mirë që do të çojë në plotësimin e nevojave për gjak të mjaftueshëm dhe të sigurt në Shqipëri, në fushën e kirurgjisë, onkologjisë, obstetrikës, por dhe atë të përkujdesjes për sëmundjet e gjakut e veçanërisht për të sëmurët me Talasemi.

Të dhurosh gjak është një akt i madh human.

Në Tiranë janë 400 fëmijë talasemik, të cilët cdo dy javë duan një qese gjak për të jetuar normal si ne.

Nisur nga situata e pandemise ne vend dhe masat e institucioneve shendetesore, protokolli i dhurimit te gjakut eshte pershtatur duke respektuar distancen 1.5 m mes krevateve te dhuruesve si edhe pajisjen e stafit dhe dhuruesve me maska mbrojtese.

Dhuron Gjak:

Cdo person i moshës 18 - 60 vjeç dhe që nuk vuan nga asnjë sëmundje kronike, mund të jetë dhurues vullnetar i gjakut.

Cdo person që do të dhurojë gjak duhet të ketë ngrënë 1-2 orë përpara dhurimit.
Ne në trupin tonë kemi 5-6 litra gjak.

Dhuruesit do t'i ushtrohen një analize paraprake nga mjekët e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut si:

- 1.Matja e temperatures (e detyrueshme per te respektuar protokollet shendetesore ne kuader te pandemise)
- 2.Hemoglobina (anemia)
- 3.Tensioni
- 4.Plotësimi i një pyetsori mbi historinë e shëndetit.

Nëse do dalin mirë këto analiza atëherë do të dhurohet gjak 300-400 ml.

Kjo sasi zëvendësohet brenda 24 orëve si lëng,ndërsa rruazat e kuqe formohen brenda 7 ditëve.

Japim apo nuk japim gjak, në trupin tonë shkatërimi dhe rindërtimi i rruazave të kuqe ndodh çdo katër muaj. Pra dhurimi i gjakut përshpejton rigjenerimin e shëndetit dhe palca bëhet më aktive për të prodhuar rruaza të kuqe të fuqishme.

Përfshihen nga dhurimi i gjakut;

Personat që mjekohen me antibiotik,(duhet te ketë dy javë nga nderprerja e një antibiotiku)

Nënat që ushqejnë femijë me gji.

Ata që kanë bërë një operacion e nuk kanë mbushur 4 muaj nga operacioni.(duhet të ketë kaluar 4 muaj nga operacioni)

Ata që nuk kanë kaluar 4 muaj nga bërja e një tatuazhi.

Personat që kanë shkuar tek Stomatologu për një pastrim gurezash apo mbushje dhe nuk kanë mbyshyr 10 dite;; Apo vendosja e një implanti duhet te kaloj 4 muaj,

Personat qe kanë kaluar Covidin duhet te kene kaluar 1 muaj, (gjithmone nese e kane kaluar shume rend, nese eshte e lehte ne forme gripi duhet te kaloje plot 2 jave).

Përfitimi i dhuruesit:

Një shëndet më të mirë dhe analizat si më poshtë:

Grup gjaku.

Hepatitet A, B, C

Transaminazat e mëlçisë

Sëmundjet seksualisht të trasmetueshme HIV, Sifilis, Gonore.

Kolesterol

Ferritinë

Proteina totale.